



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.535-2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Rexhep Ramadani me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli i paraqitur nga Rexhep Ramadani nga Gjermania, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 25.08.2021, PZAP-i ka pranuar një apel përmes email-it nga Rexhep Ramadani nga Gjermania, në të cilën pretendohet se shkak i apelit është mos përfshirja në listën e votuesve jashtë Kosovës nga KQZ-ja.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur formularët dhe dokumente identifikuese të familjarëve të tij si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe përgjigjen në ankesë të KQZ-së, konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij në KQZ, për regjistrim për votim jashtë Kosovës, më datë 18.08.2021, ora 19:49 ka dërguar vetëm një email cili nuk përmban asnjë aplikacion, asnjë dokument për regjistrim, ndërsa më datë 23.08.2021 në ora 21:14 pas afatit përfundimtar të periudhës së aplikimit për regjistrim po nga e njëjta adresë është dërguar edhe një email në KQZ, i cili përmban dokumente në formën pdf, të cilat janë dokumente të dërguara jashtë afatit të përcaktuar dhe si të tilla KQZ, nuk i ka proceduar fare.

Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh faktin se, parashtruesi i apelit nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: “*çdo person ka të drejt për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës*”, si dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e plotë, por vetëm një email i zbrazt i pa kompletuar, andaj

me të drejt KQZ-ja ia refuzuar aplikimin për rexhistrim, sepse nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara.

Apeluesi nuk ka arritur qe brenda afatit të paraparë nga KQZ-ja, të aplikon në mënyrë të rregullt ashtu që ta dorëzon aplikacionin e kompletuar me dokumentacionin e kërkuar, kompletimi i dokumentacionit pas afatit nuk është i vlefshëm dhe valid, dhe me të drejtë është refuzuar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 535-2021 më datën 27.08.2021

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në *Gjykatën Supreme të Kosovës*, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.